

UNMIK/RREG/2005/52  
20 dhjetor 2005

## RREGULLORE NR. 2005/52

### PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në qershor të vitit 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Adiministratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 25 korrik 1999 për Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Pas nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/8 të datës 6 prill 2001 për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës,

Me qëllim të themelimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në vend të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK) dhe me qëllim të sigurimit të një gjyqësori të paanshëm, të integruar, të pavarur, profesional dhe llogaridhënës, si dhe duke marrë parasysh riorganizimin aktual të sistemit gjyqësor të Kosovës,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall si në vijim:

#### Neni 1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës

1.1 Me anë të kësaj Rregulloreje themelohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës ("Këshilli") si një organ profesional nën pushtetin suprem të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) duke e zëvendësuar KGJPK-në, i cili do të shpërbëhet pas formimit të Këshillit.

1.2 Këshilli ka pavarësi të plotë në kryerjen e funksioneve të tij.

1.3 Këshilli përcakton politikat administrative dhe bën mbikëqyrjen administrative të gjyqësorit dhe të gjykatave.

1.4 Këshilli është përgjegjës për përcaktimin e politikës së punës dhe për shpalljen e rregullave e të udhëzimeve për gjyqësorin dhe gjykatat për:

(a) Punësim;

(b) Aftësim dhe

(c) Emërim, vlerësim, avancim në punë, transferim dhe disiplinë të gjykatësve, të gjykatësve laikë dhe të punonjësve të tjerë jogjyqësorë.

1.5 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ushtron pushtetin suprem lidhur me emërimin dhe largimin e gjyqtarëve nga posti i tyre.

1.6 Deri në shpalljen e rregullores me të cilën do të themelohet subjekti përgjegjës për këshillimin e PSSP-së lidhur me çështjet e emërimit, të sanksionimit dhe të shkarkimit të prokurorëve, dispozitat përkitazi me këto çështje që vlejné për gjyqtarët konsiderohen se vlejné edhe për prokurorët.

1.7 Në lëminë gjyqësore, Këshilli ka përgjegjësitë vijuese:

- (a) Ushtron përgjegjësitë lidhur me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave;
- (b) Cakton lokacionin gjeografik, numrin dhe strukturën e gjykatave në konsultim me Kuvendin e Kosovës;
- (c) Ushtron përgjegjësitë lidhur me ofrimin e kushteve teknike dhe financiare, me përkrahjen e punonjësve dhe lidhur me resurset materiale për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor;
- (d) Cakton politikat dhe organizon aftësimet e punonjësve të gjyqit, duke përfshirë aftësimet profesionale, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Kosovës, me ndihmën e plotë apo të pjesërishme të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK);
- (e) Ushtron përgjegjësitë lidhur me organizimin e provimeve për kualifikimin e gjyqtarëve përmes IGJK-së;
- (f) Ushtron përgjegjësitë lidhur me emërimin, aftësimin, sanksionimin dhe shkarkimin e punonjësve gjyqësor ndihmës;
- (g) Sipas nevojës jep informata dhe të dhëna statistikore për sistemin gjyqësor, duke përfshirë bashkëpunimin me organizatat e duhura përkitazi me monitorimin e pavarur të sistemit gjyqësor dhe
- (h) Ruan të dhënat personale që ndërlidhen me sistemin gjyqësor.

1.8 Këshilli harton dhe miraton rregulloren e brendshme të punës. Si një masë e përkohshme dhe deri në miratimin e rregullores së punës, Këshilli zbaton në formë të përshtatshme rregulloren e punës të KGJPK-së.

1.9 Këshilli shpall rregullat dhe procedurat që përcaktojnë bazën për ndërmarrjen e veprimeve disiplinore dhe procesin për trajtimin e akuzave, të hetimeve, pezullimit apo shkarkimit të cilitdo anëtari të Këshillit.

1.10 Këshilli e miraton kodin e mirësjelljes që përcakton standardet e etikës dhe të mirësjelljes profesionale, të cilat duhet të respektohen nga anëtarët e Këshillit, shkelja e të cilave paraqet bazën për sanksionim, duke përfshirë largimin nga Këshilli.

1.11 Pas emërimit secili anëtar i Këshillit betohet solemnisht përpara PSSP-së. Teksti i betimit është si në vijim:

“Solemnisht deklaroj dhe premtoj se do t’i kryej funksionet që më janë besuar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.52 dhe urdhëresave administrative të nxjerra pas saj dhe se nuk do të kërkoj e pranoj udhëzime nga asnjë burim tjetër”.

## Neni 2 Përbërja

2.1 Këshilli përbëhet prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve nga të cilët shtatë (7) janë gjyqtarë dhe katër (4) nuk janë gjyqtarë. Gjyqtarët në Këshill do të pasqyrojnë barazinë gjinore dhe shumetnicitetin.

2.2 Gjyqtarët anëtarë të Këshillit janë kryetari i Gjykatës Supreme, dy (2) gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe katër (4) gjyqtarë përfaqësues të gjykatave të tjera.

2.3 Deri në shpalljen e rregullores që themelon subjektin përgjegjës për këshillimin e PSSP-së përkitazi me çështjet e emërimit, sanksionimit dhe shkarkimit të prokurorëve, vetëm dy nga shtatë postet për gjykatësit do t’u takojnë prokurorëve.

2.4 Anëtarët e tjerë të Këshillit përpos gjykatësve janë Ministri i Drejtësisë, kryesuesi i Komisionit parlamentar për çështje legislative, juridike dhe për Kornizë Kushtetuese, kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe një profesor i lëmisë juridike.

2.5 Kryetari i Gjykatës Supreme është edhe kryetar i Këshillit.

2.6 Këshilli e zgjedh njërin nga gjyqtarët e tjerë në postin e zëvendëskryetarit të Këshillit, i cili e zëvendëson kryetarin në rastet kur ai përkohësisht mungon.

2.7 Këshilli mban takime sipas nevojës me qëllim të kryerjes së funksioneve të veta. Shtatë (7) anëtarët e Këshillit e përbëjnë kuorumin e nevojshëm për takim.

2.8 Kurdo që takimi i tillë është i lidhur me emërimin, sanksionimin dhe shkarkimin e prokurorëve, për ekzistimin e kuorumit është e nevojshme prania e dy anëtarëve nga radhët e prokurorëve.

## Neni 3 Sekretaria

3.1 Gjatë punës së tij, Këshillit do t’i ndihmojë Sekretaria e Këshillit e udhëhequr nga drejtori që zgjedhet nga Këshilli.

3.2 Sekretaria e këshillon dhe e ndihmon Këshillin në kryerjen e përgjegjësive të tij, në menaxhimin e gjyqësorit dhe të gjykatave dhe është përgjegjëse për zbatimin e vendimeve të Këshillit, si dhe është përgjegjëse për të gjitha funksionet administrative dhe të hulumtimit që ndërliken me përkrahjen e Këshillit, në pajtim me rregulloren e punës së Këshillit.

Neni 4  
Emërimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit

- 4.1 Anëtarët vijues të Këshillit shërbejnë si anëtarë sipas detyrës zyrtare:
- (a) Kryetari i Gjykatës Supreme;
  - (b) Ministri i Drejtësisë;
  - (c) Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës;
  - (d) Kryesuesi i Komisionit parlamentar për çështje legislative, juridike dhe Kornizë Kushtetuese dhe
  - (e) Një profesor i lëmisë juridike, i cili do të emërohet nga Kuvendi pas rekomandimit të Këshillit drejtues të Universitetit të Prishtinës.
- 4.2 Për një periudhë njëvjeçare pas shpalljes së kësaj Rregulloreje, dy (2) nga gjyqtarët e Këshillit do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë.
- 4.3 Në pajtim me nenin 4.2, PSSP-ja i emëron dy (2) anëtarë ndërkombëtarë nga radhët e gjyqtarëve ndërkombëtarë që shërbejnë në Kosovë.
- 4.4 Deri në shpalljen e rregullores që përcakton subjektin përgjegjës për këshillimin e PSSP-së lidhur me çështjet e emërimit, sanksionimit dhe shkarkimit të prokurorëve, një nga postet ndërkombëtare gjyqësore do të mbahet nga një prokuror ndërkombëtar.
- 4.5 PSSP-ja i emëron katër (4) gjyqtarët e tjerë në Këshill në konsultim me Kuvendin e Kosovës dhe në konsultim me Këshillin e Kuvendin, pas emërimit të përbërjes fillestare të Këshillit
- 4.6 Anëtari i Këshillit suspendohet nga posti nëse kundër tij është shpallur aktakuza apo vendimi për mbajtje në arrest para gjykimit ose nëse është dhënë urdhri për arrestimin e tij.
- 4.7 Rekomandimi i Këshillit për shkarkimin e anëtarit të Këshillit miratohet nga PSSP-ja për çfarëdo arsyeje, përveç për shpalljen fajtor për kryerjen e veprës penale.
- 4.8 Anëtari i Këshillit mund të jep dorëheqje nga pozita e tij në Këshill me anë të kërkesës për dorëheqje dhe pas njoftimit paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.
- 4.9 Mandati i anëtarit të Këshillit përfundon automatikisht kur në rastin e anëtarit sipas detyrës zyrtare ai nuk e mban më postin e cekur në nenin 4.1 dhe, në rastin e anëtarit tjetër, kur ai nuk e mban më postin e caktuar gjyqësor apo prokurorial të cekur në nenet 4.2-4.5.
- 4.10 Të gjitha emërimet e gjyqtarëve në Këshill zgjasin për një periudhë njëvjeçare (1).
- 4.11 Në rast të largimit nga posti të njërit nga anëtarët e Këshillit apo në rastin e vdekjes a dorëheqjes së anëtarit, PSSP-ja e emëron anëtarin e ri që zgjedhet nga lista e personave të propozuar për emërim, e cila dorëzohet nga Këshilli pas konsultimit me Kuvendin e Kosovës. Anëtari i emëruar kryen funksionin gjatë pjesës së mbetur të mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

### Neni 5

#### Përgjegjësitë e Këshillit lidhur me emërimin e gjyqtarëve

5.1 Përmes një shpalljeje publike, Këshilli do t'i ftojë profesionistët e fushës juridike në Kosovë që t'i parashtrajnë kërkesat për të punuar si gjyqtar dhe po ashtu do t'i ftojë kandidatët e kualifikuar të Kosovës që t'i parashtrajnë kërkesat për të punuar si gjyqtar laik. Gjithashtu, mund të pranojë rekomandimet nga pushteti rajonal dhe komunal apo nga organet gjyqësore a organet e tjera juridike përkritazi me personat që konsiderohen si të përshtatshëm për t'i intervistuar për punën e gjyqtarit laik. Këshilli i shqyrton veç e veç kërkesat për punësim dhe ia dorëzon PSSP-së rekomandimin e tij me shkrim për kandidatët duke cekur arsyet e atij rekomadimi.

5.2 Gjatë shqyrtimit veç e veç të kërkesave për punësim, anëtarët e Këshillit udhëhiqen nga nevoja e themelimit të një gjyqësori profesional, të pavarur, të paanshëm dhe shumetnik.

5.3 Gjyqtari nuk mund të mbajë ndonjë post tjetër publik a administrativ apo të angazhohet në çfarëdo pune të natyrës profesionale, qoftë me pagesë apo pa të. Këshilli mund të autorizojë gjyqtarin, sipas kushteve që i konsideron të duhura, që të angazhohet në aktivitete të jashtme, siç janë mbajtja e ligjëratave ose ushtrimi i funksioneve në fushën e profesionit të tij, të cilat nuk ndikojnë në pavarësinë ose dinjitetin e postit të tij.

5.4 Gjyqtari apo gjyqtari laik nuk mund të angazhohet në asnjë aktivitet që nuk është në përputhje me funksionet e tij, duke përfshirë angazhimin në aktivitete politike.

5.5 PSSP-ja e ushtron pushtetin suprem në emërimin e gjyqtarëve dhe të gjyqtarëve laik duke marrë parasysh rekomandimet e Këshillit sipas nenit 5.1.

### Neni 6

#### Kriteri për zgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë apo gjyqtarë laikë

6.1 Kandidatët për gjyqtar duhet t'i përmbushin kriteret minimale vijuese:

- (a) Të jenë banor të përhershëm të Kosovës;
- (b) Të kenë integritet të lartë moral;
- (c) Të jenë në gjendje t'i kryejnë detyrat dhe punën gjatë orarit të plotë;
- (d) Të kenë diplomën e fakultetit juridik, që është në përputhje me ligjin e Kosovës;
- (e) Të kenë të kryer provimin e Kosovës për judikaturë apo të jenë anëtar të Odës së Avokatëve;
- (f) Të kenë të kryer provimin pranues për gjyqtar;
- (g) Të kenë vijuar dhe përfunduar aftësimet e nevojshme sipas ligjit dhe sipas rregullave të tjera në fuqi dhe
- (h) Të kenë së paku tri (3) vite përvojë pune në lëmin juridik.

6.2 Kandidatët për të shërbyer si gjyqtar laikë duhet t'i përmbushin kriteret minimale vijuese:

- (a) Të jenë banor të përhershëm të Kosovës për pesë (5) vjet;
- (b) Të kenë mbushur së paku njëzet e pesë vjet (25) në ditën e dorëzimit të kërkesës së tyre dhe
- (c) Të kenë integritet të lartë moral dhe të mos jenë përfshirë në praktika diskriminuese të përkufizuar sipas ligjit dhe rregullave e procedurave gjyqësore.

#### Neni 7

#### Komisioni disiplinor gjyqësor

7.1 Këshilli e formon Komisionin disiplinor gjyqësor me qëllim të inicimit dhe zgjidhjes në shkallë të parë të rasteve të shkeljes nga gjyqtarët dhe gjyqtarët laikë dhe me qëllim të përcaktimit të sanksioneve të duhura me rastin vërtetimit të shkeljes.

7.2 Komisioni disiplinor gjyqësor përbëhet nga zëvendëskryesuesi i Këshillit në rolin e tij si kryetar i Komisionit dhe nga dy (2) anëtarë të Këshillit të emëruar me mandate njëvjeçare (1) rotative me pamundësi të emërimit dy herë rresht.

7.3 Të gjitha ankesat i dërgohen për shqyrtim Njesisë Gjyqësore për Inspektim (NJGJI). Pasi që Njësia Gjyqësore për Inspektim ta ketë kryer shqyrtimin e saj, vendos nëse akuzat mund t'i parashtrihen Komisionit disiplinor gjyqësor.

7.4 Komisioni disiplinor gjyqësor vendos për sanksionet disiplinore, përveç për largimin e gjyqtarëve apo gjyqtarëve laikë nga posti dhe mund të rekomandojë largimin e tillë të gjyqtarëve apo të gjyqtarëve laikë nga posti, por çdo rekomandim i tillë, duke përfshirë edhe arsyetimin e tij, duhet t'i paraqitet Këshillit me shkrim.

7.5 Komisioni disiplinor gjyqësor është i autorizuar për shqiptimin e sanksioneve vijuese:

- (a) Qortimit;
- (b) Qortimit dhe vërejtjes;
- (c) Suspendimit nga puna pa pagesë për periudhën deri në gjashtë (6) muaj;
- (d) Rekomandimit për largim nga posti apo
- (e) Rekomandimit për largim nga funksioni i gjyqtarit laik.

Në shqiptimin apo rekomandimin e sanksioneve, Komisioni gjyqësor disiplinor nuk shqipton sanksione që janë joproporcionale me shkeljen e vërtetuar.

7.6 Kundër vendimeve të Komisionit disiplinor gjyqësor mund të parashtrihet ankesa drejtpërdrejt në Këshill, ku nuk përfshihet zëvendëskryesuesi dhe anëtarët, të cilët kanë qenë të angazhuar në procedurën fillestare.

7.7 Këshilli e informon PSSP-në për çdo rekomandim të tillë për largim nga posti, ndërsa pushteti suprem për largimin e gjyqtarit apo të gjyqtarit laik i mbetet PSSP-së.

7.8 Procedurat disiplinore dhe ankimore do të përcaktohen me anë të një urdhërese administrative.

#### Neni 8

##### Administrimi i gjyqësorit dhe i gjykatave

8.1 Këshilli ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe përcakton politikat dhe procedurat e administrimit dhe të gjyqësorit.

8.2 Këshilli shpall rregullat dhe procedurat e brendshme të cilat paraqesin politikat administrative për funksionimin e duhur të gjyqësorit. Rregullat dhe procedurat e brendshme përcaktojnë fushëveprimin e aktiviteteve, të përgjegjësive dhe të detyrave për administratën gjyqësore dhe të gjykatave.

8.3 Sekretaria e Këshillit është përgjegjëse që në emër të Këshillit të zbatojë politikat dhe udhëzimet administrative gjyqësore dhe të gjykatave, të cilat ndërlidhen me menaxhimin dhe administrimin e duhur të gjyqësorit dhe të gjykatave.

8.4 Kryetarët e gjykatave mbajnë përgjegjësinë për administrimin e përditshëm të gjykatave të tyre dhe janë të obliguar t'i kryejnë detyrat e deleguara nga Këshilli në përputhje me rregullat dhe procedurat e Këshillit.

8.5 Kryetarët e gjykatave i menaxhojnë dhe i mbikëqyrin gjyqtarët dhe gjyqtarët laikë dhe janë përgjegjës për planifikimin e caktimin e detyrave gjyqësore, duke përfshirë organizimin, bashkërendimin dhe funksionimin e gjykatave, aktiviteteve financiare të gjykatave dhe aktiviteteve të tjera të parapara sipas rregullave dhe procedurave.

8.6 Këshilli e shpall procedurën për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave.

#### Neni 9

##### Përgjegjësitë e Këshillit lidhur me buxhetin e sistemit gjyqësor të Kosovës

9.1 Këshilli është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të përgatitjes dhe të zbatimit të buxhetit vjetor për tërë sistemin gjyqësor të Kosovës.

9.2 Këshilli përcakton buxhetin e duhur vjetor në bashkëpunim me gjykatat që realizohet përmes kryetarëve të gjykatave.

9.3 Këshilli e menaxhon buxhetin e tij në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësinë për monitorimin e shpenzimeve të fondeve të ndara dhe për funksionet e kontabilitetit e të kontrollit financiar, në përputhje me ligjin në fuqi.

9.4 Propozimi për buxhetin vjetor të gjykatave përfshin dispozitat për Këshillin dhe për sistemin gjyqësor.

9.5 Këshilli ia dorëzon buxhetin vjetor Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në përputhje me udhëzimet ekzistuese të Ministrisë së Financave. Para se t'i dorëzohet buxheti Ministrisë së Financave, Këshilli ia ofron kopjen e buxhetit Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 10  
Pagat dhe beneficionet

Në konsultim me Këshillin, PSSP-ja përcakton me urdhëresë administrative honoraret që duhet të paguhen për punën e kryer nga Këshilli.

Neni 11  
Zbatimi

PSSP-ja mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 12  
Dispozitat kalimtare

12.1 Këshilli merr autorizimin mbi të gjitha rastet dhe çështjet që aktualisht shqyrtohen nga KGJPK-ja.

12.2 Çdo masë e shqiptuar nga KGJPK-ja, duke përfshirë mes tjerash suspendimin e gjyqtarëve, mbetet në fuqi derisa të arrihet vendimi përfundimtar për rastin dhe konsiderohet se është marrë nën autorizimin e Komisionit disiplinor gjyqësor të Këshillit.

12.3 KGJPK-ja mban përgjegjësinë për administrimin e gjykatave deri në themelimin e Këshillit. Gjatë kësaj periudhe të përkohshme, drejtori i administratës së Departamentit të Çështjeve Gjyqësore i raporton kryesuesit të KGJPK-së.

Neni 13  
Shfuqizimi

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/8 shfuqizohet duke filluar nga data e themelimit zyrtar të Këshillit.

Neni 14  
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 15  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 dhjetor 2005.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm